



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT BERAT
KRYETARI**

Nr. 508/2 Prot.

Berat, më 19.07.2024

Lënda: Kërkesë për publikim vendi të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Këshilli i Qarkut Berat ka vendosur të shpall procedurën e konkurrimit për grupin e pozicioneve , lloji i diplomës “Drejtësi / Shkenca Juridike, niveli minimal i diplomës “ Master Shkencor”.

Për këtë arsye, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij.

Për sa më sipër kërkojmë publikimin në portalin “ Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” shpalljen përkatëse për kategorinë e ulët drejtuese, për pozicionin Përgjegjës i Sektorit Juridik Burimeve Njerëzore Informimit dhe Statistikave.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

KRYETAR

Donald MOLISHTI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT BERAT
KRYETARI**

Nr. 509 Prot.

Berat, më 17.07.2024

URDHËR

Nr. 100, Datë 17.07.2024

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL**

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM nr. 243 datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar si dhe në planin vjetor të pranimit për vitin 2024,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil për pozicionin e lirë:
 - Përgjegjës i Sektorit Juridik Burimeve Njerëzore Informimit dhe Statistikave
2. Me zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sektori Juridik Burimeve Njerëzore Informimit dhe Statistikave, në cilësinë e strukturës përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Donald MOLISHTI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT BERAT
SEKTORI JURIDIK BURIMEVE NJERËZORE INFORMIMIT DHE
STATISTIKAVE

Nr. 509/1 Prot.

Berat, më 19.07.2024

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE / NGRITJE NË DETYRE
PËR KATEGORINË E ULËT DREJTUESE

- Përgjegjës i Sektorit Juridik Burimeve Njerëzore Informimit dhe Statistikave

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, "Për nënpunësin civil", i ndryshuar si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar me vkm nr. 748, datë 19.12.2018, Këshilli i Qarkut Berat, në vijim të urdhërit Nr.100 datë 17.07.2024 të Kryetarit, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin

1(një) Përgjegjës i Sektorit Juridik Burimeve Njerëzore Informimit dhe Statistikave

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJEN PARALELE DO TË JETË
29.07.2024

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR NGRITJE NË DETYRË DO TË JETË
05.08.2024

Përshkrimi përgjithësues i punës dhe detyrat objektive konkrete për pozicionin Përgjegjës i Sektorit Juridik Burimeve Njerëzore Informimit dhe Statistikave është si më poshtë:

Përgjegjësi i Sektorit Juridik / Juristi në Këshillin e Qarkut Berat ka për mision të sigurojë përputhshmërinë e politikave të ndjekura nga Këshilli i Qarkut Berat- në fushat ku institucioni ushtron funksionet dhe veprimtarinë e tij, në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë:

Përgjegjësi i Sektorit Juridik Burimeve Njerëzore Informimit dhe Statistikave / Juristi ka përgjegjësi për:

1. Siguron mbështetje dhe asistencë ligjore dhe juridike mbi çështjet që kërkohen për t'u trajtuar, në ushtrimin e funksioneve dhe kryerjen e detyrave të të gjitha strukturave të Këshillit të Qarkut Berat

2. Siguron ofrimin e vazhdueshëm të asistencës ligjore dhe juridike për njohjen më të mirë, kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit nga strukturat e Këshillit të Qarkut Berat.
3. Ofron asistencë juridike dhe ligjore për Kryetarin e Këshillit të Qarkut në ushtrimin e të drejtës së Këshillit të Qarkut si person juridik (të drejtën e lidhjes së kontratës, të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridike, të drejtën e përfaqësimit, të drejtën e ngritjes së padisë civile, të drejtën e mbajtjes së llogarive dhe të drejtat për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave, sipas ligjit)
4. Siguron zbatimin e legjislacionit në fuqi për çështjet që i propozohen për miratim organeve të qeverisjes vendore dhe atyre që funksionojnë pranë saj me ligje të veçanta, si më poshtë
 1. relacionet dhe projekt-vendimet e Këshillit të Qarkut;
 2. aktet e Kryetarit të Qarkut (vendime, urdhra dhe urdhëresa);
5. Siguron dhënien e konsulencës së nevojshme ligjore si dhe kontribuon në zgjidhjen e kërkesave për gjetjen e opsioneve dhe zgjidhjeve ligjore mbi problemet që parashtrihen në rrugë administrative, për çështje me natyrë ligjore (juridike) nga strukturat e Këshillit të Qarkut Berat
6. Ndjek të gjitha konfliktet gjyqësore, në të tre shkallët e gjykimit, me qëllim përfaqësimin sa më dinjitoz të Këshillit të Qarkut Berat në mbrojtje të interesave publike
7. Realizon marrëdhënie bashkëpunimi me Zyrën Përmbarimore, në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, përgatitja e kërkesave përkatëse, në rastet e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore
8. Standardizon dhe përmirëson kontratat që Këshilli i Qarkut Berat do të lidhë me subjektet fizik e juridik, vendas e të huaj, në përputhje me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë, për sa i përket përmbajtjes dhe kushteve të tyre, duke bashkërenduar me strukturat përkatëse të Këshilli të Qarkut;
9. Angazhohet (në bashkëpunim dhe pas kërkesës së strukturave përkatëse të Këshillit të Qarkut), për monitorimin e zbatimit të të drejtave dhe detyrimeve të marra përsipër në kontrata dhe marrëveshje, veçanërisht në përcaktimin e sanksioneve dhe përgjegjësisë për zbatimin e tyre, duke synuar minimizimin e kostos financiare për institucionin;
10. Siguron përdorimin sa më ekonomik dhe efektiv të fondeve publike dhe zbatimin e procedurave të prokurimit në mbështetje të legjislacionit në fuqi
11. Siguron transparencën dhe jo diskriminimin gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për punët publike dhe investimet e lidhura me to;
12. Realizon, në bashkëpunim me strukturat e Këshilli të Qarkut dhe komisionet ad hoc të ngritura posaçërisht, brenda afatit të përcaktuar nga ana ligjore të gjitha prokurimet për punët publike apo investimet, duke bërë të mundur realizimin e objektivave primare të Këshilli të Qarkut Berat
13. Koordinon, asiston dhe zbaton në sektorin ku është përgjegjës politikat dhe strategjitë për menaxhimin me efektivitet të burimeve njerëzore në Këshillin e Qarkut Berat në zbatim të Ligjit të Statusit të Nëpunësit Civil, akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre dhe vendimeve të Këshillit të Qarkut

14. Koordinon, asiston dhe zbaton në sektorin ku është përgjegjës procesin e rekrutimit në shërbimin civil, sipas kuadrit ligjor në fuqi; me qëllim tërheqjen në administratë të elementëve më të aftë profesionalisht duke u dhënë preferencë, sipas ligjit, elementëve më aftësi të spikatura profesionale dhe të shkollimit cilësor, kjo si domosdoshmëri për rritjen e performancës në administratën e Këshillit të Qarkut.

1 - LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 - Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë :

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv, mirë apo shumë mirë nga punëdhënësi i fundit

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Shkencor, dega **Drejtësi / Shkenca Juridike** ose profile shumë të ngjashme.
2. Të ketë eksperiencë dhe përvojë pune në profesion, të paktën 5 vjeçare
3. Të ketë njohuri të mira në programet bazë të kompjuterit
4. Të ketë aftësi të mira komunikuese, menaxhuese, aftësi dalluese në punën në grup
5. Të ketë njohuri të mira në një nga gjuhët e BE-së, preferencë: gjuha angleze
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, bazuar në Ligjin Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"

1.2 - Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose dorazi pranë Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Berat, brenda datës **29.07.2024** dokumentet si më poshtë:

1. Kerkese me shkrim për aplikim (leter motivimi)
2. Curriculum Vitae (Jetshkrim standart)
3. Fotokopjo të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
4. Certificate të perberjës familjare dhe fotokopje kartës së Identitetit.
5. Dëshmi kualifikimi (fotokopjo e notëruar) nese ka.
6. Aktin e statusit të nëpunësit Civil
7. Vleresim pune nga punëdhënësi i fundit.
8. Vertetim që nuk kanë masë administrative në fuqi
9. Dëshmi i gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penale), vërtetim nga Gjykata, vërtetim nga Prokuroria.
10. Raport mjeko-ligjor nga komisioni mjekesor kompetent i aftë për punë
11. Fotokopje të Librezës së punës të të gjitha rubrikave të plotësuara.

1.3 - Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Duke filluar nga data 01.08.2024 Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, do të shpallë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga kjo zyrë, nëpërmjet email- it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatet të cilët rezultojnë të pakualifikuar brenda 3 (tre) diteve nga shpallja e listës paraprake të verifikimit të kandidateve, kanë të drejtë të paraqesin ankesat e tyre në njësine e menaxhimit të burimeve njerëzore. Brenda 5 (pese) dite punë nga data e paraqitjes së ankesës, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore u kthen përgjigje kandidateve të pakualifikuar.

1.4 - Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin.
2. Eksperiencën e tyre të mëparshme.
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
1. Kushtetuta Republikës së Shqipërisë
2. Ligji 152/2013 "Për nëpunësin Civil"
3. Ligji Nr. 8652 datë 31.07.2000, "Për Organizimin e Funkcionimin e Qeverisjes Vendore"
4. Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë"
5. Ligji Nr. 9367 datë 07.04.2005, "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit"
6. Ligji Nr. 9131 datë 08.09.2003 "Rregullat e Etikës në Administratën Publike"
7. Njohuritë mbi ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM në zbatim të tij.
8. Kodi i Procedurës Civile
9. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
10. Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave për organet e pushtetit vendor

1.5 - Mënyra e vlerësimit të kandidatëve për lëvizjen paralele

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:
Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Totali i për këtë vlerësim është 40 pikë i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm.

1.6 - Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Berat do të shpallë fituesin në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Faqen Zyrtare të Këshillit të Qarkut, dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë procedurë do të informohen për fazat e mëtejshme të saj, lidhur me

1. datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
2. datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
3. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve;

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Berat do të japë çdo informacion tjetër të nevojshëm që mund të kërkohej, sipas ligjit.

2 – NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se për këto pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezultojnë se vendi është përsëri vakant, pozicioni është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë / pranim nga jashtë

2.1 - Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për ngritjen në detyrë janë :

4. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, një kategori më poshtë kategorisë për të cilën po aplikon.
5. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
6. Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv, mirë apo shumë mirë nga punëdhënësi i fundit
7. të plotësojë kushtet e tjera, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil;
8. të përmbushë kriteret e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

9. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Shkencor, dega **Drejtësi / Shkenca Juridike** ose profile shumë të ngjashme.
10. Të ketë eksperiencë dhe përvojë pune në profesion, të paktën 5 vjeçare
11. Të ketë njohuri të mira në programet bazë të kompjuterit
12. Të ketë aftësi të mira komunikuese, menaxhuese, aftësi dalluese në punën në grup
13. Të ketë njohuri të mira në një nga gjuhët e BE-së, preferencë: gjuha angleze

14. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, bazuar në Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”

2.2 - Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose dorazi pranë Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Berat, brenda datës **05.08.2024** dokumentet si më poshtë:

1. Kërkese me shkrim për aplikim (letër motivimi)
2. Curriculum Vitae (Jetëshkrim standard)
3. Fotokopjo të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
4. Certificate të përberjes familjare dhe fotokopje kartës së Identitetit.
5. Dëshmi kualifikimi (fotokopjo e noteruar) nëse ka.
6. Aktin e statusit të nëpunësit Civil
7. Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.
8. Vërtetim që nuk kanë masë administrative në fuqi
9. Dëshmi i gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penale), vërtetim nga Gjykata, vërtetim nga Prokuroria.
10. Raport mjeko-ligjor nga komisioni mjekësor kompetent i aftë për punë
11. Fotokopje të Librezës së punës të të gjitha rubrikave të plotësuar.

2.3 - Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Duke filluar nga data 08.08.2024, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, do të shpallë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga kjo zyrë, nëpërmjet email- it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatet te cilet rezultojne te pakualifikuar brenda 3 (tre) diteve nga shpallja e listes paraprake te verifikimit te kandidateve, kane te drejte te paraqesin ankesat e tyre ne njesine e menaxhimit te burimeve njerezore. Brenda 5 (pese) dite pune nga data e paraqitjes se ankeses , njesia e menaxhimit te burimeve njerezore u kthen pergjigje kandidateve te pakualifikuar.

2.4 - Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë

15. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin.
16. Eksperiencën e tyre të mëparshme.
17. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
18. Kushtetuta Republikës së Shqipërisë
19. Ligji 152/2013 “Për nëpunësin Civil”
20. Ligji Nr. 8652 datë 31.07.2000, “Për Organizimin e Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”

21. Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë"
22. Ligji Nr. 9367 datë 07.04.2005, "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit"
23. Ligji Nr. 9131 datë 08.09.2003 "Rregullat e Etikës në Administratën Publike"
24. Njohuritë mbi ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM në zbatim të tij.
25. Kodi i Procedurës Civile
26. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
27. Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave për organet e pushtetit vendor

2.5 - Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Testimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Dokumentacionin e dorëzuar, që përfshin jetëshkrimin dhe që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al"

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm .

2.6- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Berat do të shpallë fituesin në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit . Faqen Zyrtare të Këshillit të Qarkut, dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike .

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë procedurë do të informohen për fazat e mëtejshme të saj, lidhur me:

- datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve:

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Berat do të japë çdo informacion tjetër të nevojshëm që mund të kërkoet, sipas ligjit.

KRYETAR

Donald MOLISHTI